



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

## **RREGULLORE**

**“PËR ORGANIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË DOKTORATËS NË  
FAKULTETIN E GJUHËVE TË HUAJA,**

**UNIVERSITETI I TIRANËS”**



**Miratuar me Vendim Dekanati**

Nr. 14 datë 09.04.2026

## **Neni 1 Qëllimi**

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është të përcaktojë rregulla të përgjithshme mbi mënyrën e organizimit dhe funksionimit të programeve të studimit të doktoratës në njësitë bazë të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës.

## **Neni 2 Baza ligjore**

Kjo Rregullore mbështetet në Ligjin nr 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr 41, datë 24.01.2018 ‘Për Elementet e Programeve të Studimit të Ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, i ndryshuar; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 112 datë 23.02.2018 “Për përcaktimin e kritereve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë “Profesor i Asociuar” dhe “Profesor”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 777, datë 26.12.2018, “Për kontrollin antiplagjiaturë të disertacioneve për fitimin e gradave shkencore”, i ndryshuar; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 75, datë 12.02.2018, “Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”; Udhëzimi i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 52, datë 03.12.2015 “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar; Udhëzimin e Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 16, datë 08.07.2019, “Për paisjen e institucioneve të arsimit të lartë me regjistrin themeltar të studentëve, regjistrin e arritjeve akademike dhe regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave”; Udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe atij të Financave dhe Ekonomisë nr. 20, datë 20.09.2019 “Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimin shkencor”; Udhëzimin e Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 29, datë 18.12.2019 “Për krijimin dhe administrimin e regjistrave shtetërorë të gradave shkencore dhe titujve akademikë të lëshuar në Republikën e Shqipërisë”; Udhëzimin e Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 1, datë 14.01.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisve kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 10, datë 30.03.2020 “Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në Regjistrin Shtetëror të Diplomave dhe Certifikatave për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor”; Udhëzimi i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 29, datë 10.09.2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL”; si edhe Statuti i Universitetit të Tiranës.

## **Neni 3 Objektivat e Programit të Doktoratës**



- 3.1 Programet e studimit të doktoratës përfshihen në ciklin e tretë të studimeve universitare, në përfundim të të cilit lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor”.
- 3.2 Programi i doktoratës synon të nxisë kërkimin shkencor në një fushë/ nënfushë të caktuar, duke u orientuar drejt krijimit, thellimit, rikonceptimit dhe riintegritimit të njohurive shkencore, për të sjellë risi në mendimin shkencor dhe prurje me interes dhe dobi shoqërore.
- 3.3 Studimet e doktoratës kanë në themel të tyre kërkimin shkencor dhe veprimtarinë krijuese të pavarur, si bazë për përgatitjen e tezës së doktoratës, të nevojshme për marrjen e gradës shkencore “Doktor” dhe lidhen me projekte kërkimore të njësisë bazë si dhe kualifikimin dhe rritjen profesionale të personelit akademik. Kandidati aplikon në bazë të kuotave që janë shpallur nga njësitë bazë, në kuadër të një projekti kërkimor shkencor.
- 3.4 Studimet e doktoratës ndërtohen mbi programe individuale për aftësim të pavarur të kandidatëve në kërkimin shkencor, në fushat/nënfushat e përcaktuara nga njësitë bazë. Njësitë bazë shpallin fushat/ nënfushat kryesore sipas objektivave të tyre, ose fusha të përbashkëta ndërmjet tyre me prioritet për thellimin e kërkimit shkencor.
- 3.5 Kandidati aplikon individualisht në programin e studimit të miratuar në fushat/ nënfushat e kërkimit shkencor, të ofruara nga njësia bazë. Njësia bazë miraton programet individuale të kërkimit të kandidatëve vetëm për ato fusha/nënfusha, të cilat u përkasin programeve të miratuara të doktoratës që ajo ofron, nisur nga prioritetet e saj ose të IAL-së përkatëse.

#### **Neni 4 Organet**

- 4.1 Njësitë bazë të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja janë përgjegjëse për organizimin dhe drejtimin e programeve të studimit të doktoratës. Kriteret e pranimit të studentëve për programin e studimit të doktoratës të përcaktuara nga njësitë bazë, i përcillen për miratim Dekanatit.
- 4.2 Nëse programi i studimit ofrohet nga më shumë se një njësi bazë, organizimi dhe drejtimi i programeve të studimit të doktoratës, si edhe kriteret, përcaktohen në bashkëpunim të njësisë bazë me njëra-tjetrën. Në rast të programeve që përfshijnë më shumë se një njësi bazë, njëra prej njësisë bazë caktohet si përgjegjëse për ofrimin e programit të kërkimit të kandidatit, në dakordësi midis tyre. Njësia/Njësitë bazë mund të mbështeten edhe nga qendrat kërkimore shkencore të njësisë kryesore për realizimin e programit të doktoratës.
- 4.3 Përgjegjësi i programeve të studimit të doktoratës në nivel njësie kryesore është Zëvendësdekani për kërkimin shkencor.



- 4.4 Komisioni për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor” është përgjegjës për të vlerësuar dosjen e kandidatit, ngritjen e jurisë dhe për të marrë vendime për dhënien e gradës shkencor “Doktor”.
- 4.5 Vlerësimi i punimit doktoral të kandidatit për gradën shkencore “Doktor” realizohet nga Juria e posaçme e ngritur për këtë qëllim.

## **Neni 5**

### **Organizimi i programeve të studimit të doktoratës**

5.1. Çdo njësi bazë mund të formulojë propozimin për hapjen e programeve të studimit të doktoratës, nëse plotëson kushtet e parashikuara në kuadrin ligjor në fuqi, përfshirë, por jo vetëm:

- a) ka personel akademik me titull “Profesor i Asociuar” ose “Profesor”;
- b) ka numrin e nevojshëm të personelit akademik për të udhëhequr çdo student të doktoratës në veprimtaritë e kërkimit dhe të detyrave përkatëse didaktike;
- c) ka struktura të posaçme operative dhe kërkimore për veprimtaritë e parashikuara nga programi i studimit të doktoratës (labororë, biblioteka dhe infrastrukturën e nevojshme);
- ç) ka burime financiare mbështetëse;

5.2. Njësia bazë nëpërmjet njësisë kryesore, i paraqet Senatit të Universitetit propozimin për hapjen e programit të ri të studimit të doktoratës, ose propozimin për riorganizimin e një programi ekzistues.

5.3. Propozimi duhet të përmbajë:

- a. Fushën/nënfushën e kërkimit shkencor dhe emërtimin e programit të studimit të doktoratës;
- b. Afatet kohore të realizimit të programit të studimit;
- c. Fondet financiare për realizimin e procesit të studimit, përfshirë edhe mundësinë e vetëfinancimit ose të granteve për projekte kërkimore;
- ç. Parashikimin për numrin maksimal të studentëve, që mund të regjistrohen çdo vit në programet e doktoratës, i cili përcaktohet në përputhje me kapacitetet e njësisë bazë;
- d. Kriteret e pranimit dhe të përzgjedhjes së aplikantëve fitues, të cilat përcaktohen nga njësia bazë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore dhe sipas parimit të thellimit të studimit në fushë të njëjtë apo të përafërt me studimet e ciklit të parë dhe të dytë;
- dh. Personelin akademik, që do të realizojë udhëheqjen e doktorantëve, si edhe nëse në ekipet mësimore do të përfshihet personel akademik i ftuar, i cili duhet të jetë i miratuar nga drejtuesi i njësisë kryesore;
- e. Të dhëna për strukturën organizative dhe drejtimin e programeve të studimit të doktoratës, që drejtojnë administrativisht programin e doktoratës, kur ato janë ndërdisiplinare;



ë. Të dhëna mbi përvojat e mëparshme të strukturave të FGJH-së në formime pasuniversitare, nëse kanë pasur.

**5.4** Studimet e doktoratës organizohen në kuadër të një projekti kërkimor-shkencor e zhvillimor dhe realizohen në koordinim me veprimtari të kërkimit të grupeve mësimore - kërkimore brenda njësisë/njësave bazë, njësave kryesore dhe UT-së. Këto njësi aplikojnë për financim pranë AKKSHI-së ose pranë institucioneve të tjera financuese kombëtare dhe ndërkombëtare. Në rastet e kandidatit me statusin e personelit akademik të brendshëm, studimet e doktoratës mund të mbështeten në burimet e brendshme të UT-së. Për kryerjen e studimeve të doktoratës, kandidati mund të përfitojë edhe financime nga subjekte të tjera apo dhe të vetëfinancohet.

## Neni 6

### Kërkesat themelore dhe procedura e regjistrimit të kandidatëve

**6.1.** Për të kryer regjistrimin në programet e studimit të doktoratës, studenti duhet të plotësojë këto kritere:

- a. të ketë angazhim akademik pranë një institucioni të arsimit të lartë, apo të jetë personell kërkimor në një institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar;
- b. të ketë përfunduar studimet e larta dhe të zotërojë një diplomë të ciklit të dytë “Master i shkencave”/ “Master i arteve”; një diplomë të integruar të nivelit të dytë, ose një diplomë sipas sistemit të vjetër apo titull akademik të barasvlershëm të fituar jashtë vendit dhe të njohur nga organet kompetente. Këto studime kandidati duhet t'i ketë kryer në shkenca gjuhësore, didaktike dhe letrare ose në ato të shkencave humane të përafërta me këtë program studimi. Nëse kandidati nuk ka mbaruar studimet pranë Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, rast pas rasti, sipas fushave specifike, në bashkëpunim me udhëheqësin, do të plotësojë formimin teorik kërkimor shkencor, do të realizojë aktivitete specifike mbi metodologjinë e kërkimit shkencor.
- c. të ketë notë mesatare të përgjithshme:
  - jo më pak se 8.00 (tetë) në studimet e ciklit të parë dhe të dytë së bashku,
  - jo më pak se 8.00 (tetë) në zotërimet e një diplome të integruar të nivelit të dytë (DIND) ose mesatare të barazvlefshme për studimet e kryera jashtë vendit.
- ç. të ketë mbrojtur një nga gjuhët e huaja: *anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht ose spanjisht* në përputhje me nivelet e parashikuara në pikën 3 të Udhëzimit Nr. 52, datë 03.12.2015 “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar sipas Udhëzimit nr. 10 datë 16.06.2023. Për pranimin në programin e studimeve të ciklit të tretë, kandidati duhet të ketë njohje



të gjuhës së huaj të paktën në nivelin B2 <sup>1</sup>. Në rast se kandidati ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri;

- d. të ketë dy rekomandime nga persona që kanë titullin akademik “Profesor i Asociuar” ose “Profesor” të cilët njohin aftësitë akademike dhe profesionale të kandidatit;
- dh. të mos jenë marrë masa disiplinore ndaj tij apo të mos jetë gjetur në shkelje të rregullave të etikës së kërkimit shkencor, të të drejtave që burojnë nga pronësia intelektuale apo shkelje të rregullave kundër plagjaturës, si edhe të vetëdeklarojë se është në gjendje të zbatojë standardet shkencore dhe etike.
- e. të mos jetë i dënuar për kryerjen e një kundravajtje/vepre penale;
- ë. të vetëdeklarojë se është në gjendje të zbatojë standardet shkencore dhe etike;
- f. të vetëdeklarojë se do të përballojë detyrimet financiare të programit të studimit përkatës.

**6.2** Kërkesa e studentit kandidat për të ndjekur programin e studimit të doktoratës, në të cilën paraqitet propozimi për temën, objektivat e kërkimit shkencor dhe risitë që do të sjellë, përfshihet në dosjen personale, që përmban edhe dokumentet e mëposhtme:

- a. curriculum vitae;
- b. kopje të noterizuar të diplomave, të shoqëruara me suplementet e diplomës ose listën e notave me kreditet përkatëse. Diplomat e fituara jashtë vendit duhet të shoqërohen me vërtetimin e njohjes/ekuivalentimit nga ministria përgjegjëse për arsimin; Kopje të noterizuar të diplomave të ciklit të tretë “Master ekzekutiv“, diplomë specializimi, ose të diplomave ekuivalente me to, shoqëruar me listën e notave ose suplementin e diplomës, nëse kandidati ka të tilla;
- c. fotokopje të kartës së identitetit/pasaportës;
- ç. certifikatë e gjendjes gjyqësore;
- d. dy rekomandime nga personeli akademik me titull “Profesor i Asociuar” ose “Profesor”;
- dh. dëshmi të gjuhës së huaj, sipas pikës 6.1 (d); Përfshihen ata që kanë mbaruar studimet universitare në një nga këto gjuhë.
- e. dëshmi dhe vërtetime në lidhje me kualifikime, trajnime, provime pasuniversitare ose artikuj shkencorë që mund të ketë kryer, apo pjesëmarrje në konferenca shkencore;
- ë. deklaratë vetjake e studentit për përballimin e shpenzimeve të programit të studimeve të doktoratës, nëse e ka këtë mundësi;

<sup>1</sup> Udhëzimi nr. 10 datë 16.06.2023 - Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 52, datë 03.12.2015 “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në Institucionet e Arsimit të Lartë”, i ndryshuar



- f. deklarimi i nënfushës/temës ku aplikanti paraqet interes në aplikim (formular kërkesa).
- g. vërtetimi i njësisë bazë për pranimin e dokumentacionit për aplikim;
- gj. propozimi i kërkimit shkencor, ku të evidentohen objektivat e kërkimit shkencor, metodologjia që do të ndiqet, nevoja për studim të thelluar në fushën e propozuar dhe risitë që pritet të sjellë punimi, i punës kërkimore shkencore i ndarë në vite, si dhe mundësia që studimi të mbulohet nga grante kërkimore-shkencore;
- h. vërtetim nga qendra e punës, që vërteton se kandidati ka angazhim akademik pranë një institucioni të arsimit të lartë, apo është personel kërkimor në një institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar;
- i. mandat pagese për tarifën e aplikimit;
- j. vetëdeklarim të aplikantit se do të zbatojë standardet shkencore dhe etike.
- k. vërtetim që nuk ka masë disiplinore në fuqi dhe nuk ka marrë kurrë masë disiplinore për largim nga puna, si dhe nuk është gjetur me shkelje të rregullave të etikës së kërkimit shkencor, të të drejtave që burojnë nga pronësia intelektuale apo shkelje të rregullave kundër plagjiaturës.

**6.3** Kërkimi shkencor në kuadrin e programit të doktoratës zhvillohen si program individual i doktorantit që drejtohet nga udhëheqësi/t, personel akademik, i kategorisë “Profesor”. Në rastin e bashkëudhëqjes vetëm njëri nga bashkëudhëqësit mund të ketë titullin “Profesor i asociuar”.

Numri i doktorantëve që një udhëheqës drejton njëkohësisht, përfshin të gjitha udhëheqjet që personeli akademik ndjek në të gjitha institucionet e arsimit të lartë brenda vendit dhe udhëheqjet/ bashkëudhëqjet që ndjek në institucionet e arsimit të lartë brenda vendit ose vendet anëtare të OECD-së, BE-së ose G-20-ës ku ai është i angazhuar.

Ky numër është:

- jo më shumë se 3 (tre), në rastin e personelit akademik që mban titullin “Profesor”;
- jo më shumë se 2 (dy), në rastin e personelit akademik që mban titullin “Profesor i asociuar”

**6.4** Dosja e kërkesës për regjistrim në programin e studimeve të doktoratës shqyrtohet nga Komisioni *ad hoc* i ngritur me vendim të njësisë bazë. Ky komision i shtrin efektet e funksionimit të tij deri në momentin e përzgjedhjes së kandidateve, shpalljen e fituesve dhe ankimimit. Përbërja e Komisionit ad-hoc duhet të jetë në numër tek dhe jo më pak se 3 (tre) anëtarë që mbajnë titullin “Profesor” dhe/ose “Profesor i Asociuar”.

Në rastet kur njësi bazë nuk plotëson numrin e anëtarëve për të krijuar komisionin ad-hoc, mund të përfshihen “Profesor” dhe/ose “Profesor i Asociuar” të një njësie tjetër me propozim të vetë njësisë bazë dhe me miratimin e drejtuesit të njësisë kryesore.



Anëtarë të këtij Komisioni duhet të jenë Profesorë/ Profesorë të Asociuar që kanë propozuar dhe u janë miratuar projekte kërkimore shkencore dhe drejtuesit e njësive bazë. Metodologjia dhe procedurat e vlerësimit të dosjeve të kandidatëve miratohen nga Dekanati, bëhen transparente dhe publikohen në faqen e internetit të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja së bashku me afatet e shqyrtimit të dosjeve.

- 6.5 Komisioni *ad hoc*, pas verifikimit të përmbushjes së kriterëve themelore, jo më vonë se 30 ditë nga mbyllja e aplikimeve, bën përzgjedhjen e kandidatëve, mbështetur në propozimin e aplikantit dhe në dokumentacionin në dosjen përkatëse, referuar një liste të qartë dhe transparente mbi pikëzimin e kriterëve specifike të aplikantëve.
- 6.6 Vlerësimi i kandidatëve përfshin dy faza të njëpasnjëshme, që janë vlerësimi i dosjes dhe intervista. Vetëm kandidatët e kualifikuar nga faza e shqyrtimit të dosjeve i nënshtrohen intervistës. Komisioni ad-hoc njofton kandidatët që kanë kaluar ose jo fazën e parë të vlerësimit dhe cakton datën e intervistës.
- 6.7 Komisioni ad-hoc i propozon njësisë bazë udhëheqësin për secilin kandidat në përputhje me fushën dhe nënfushën e studimit dhe duke i dhënë prioritet kategorisë Profesor/ Profesor të Asociuar që kanë propozuar dhe u janë miratuar projekte kërkimore shkencore. Udhëheqësi shkencor i propozuar nuk duhet të ketë konflikt interesi me studentin doktorant që do të udhëheqë gjatë punimit. Njësia bazë miraton udhëheqësit e punimeve të doktoratës. Deklarata e konfliktit të interesit dhe deklarata e gatishmërisë së udhëheqësit shkencor për të udhëhequr kandidatin i bashkëngjitet dosjes.
- 6.8 Lista paraprake e kandidatëve të përzgjedhur nga Komisioni *ad hoc* 2 ditë pas intervistës miratohet paraprakisht në mbledhjen e njësisë bazë dhe i përcillet për miratim drejtuesit të njësisë kryesore, i cili shpall listën paraprake të kandidatëve fitues në faqen zyrtare të njësisë.
- 6.9 Kandidati ka të drejtë të ankimojë procedurën e vlerësimit, brenda dy ditëve pune nga shpallja e listës paraprake të kandidatëve fitues nga drejtuesi i njësisë kryesore në faqen zyrtare të njësisë. Ankimimi i paraqitet drejtuesit të njësisë kryesore brenda 2 (dy) ditëve dhe dorëzohet pranë protokollit të njësisë kryesore. Drejtuesi i njësisë kryesore e përcjell në Komisionet ad- hoc të njësisë bazë përkatëse, të cilët duhet të bëjnë rivlerësimin e rastit dhe të kthejnë përgjigje jo më vonë se 48 orë nga përfundimi i afatit të ankimit. Përgjigjja pas shqyrtimit të ankimit i përcillet drejtuesit të njësisë kryesore, i cili brenda 2 (dy) ditëve pune, informon ankuesin.
- 6.10 Shpallja e listës përfundimtare të kandidatëve fitues bëhet nga drejtuesi i njësisë kryesore, pas përfundimit të procesit të ankimit.
- 6.11 Dosjet e kandidatëve fitues përcillen pranë Degës së kualifikimit shkencor dhe botimeve shoqëruar me një procesverbal në lidhje me përmbajtjen e dosjes.
- 6.12 Fituesit regjistrohen në regjistrin e njësisë kryesore që ofron programin e doktoraturës brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga shpallja e listës përfundimtare të fituesve.
- 6.13 Midis kandidatit fitues dhe përgjegjësit të programeve të studimit të doktoratës në nivel njësie kryesore, lidhet një kontratë tip jo më vonë se 45 ditë nga përfundimi i afatit të regjistrimit në programin e doktoraturës.
- 6.14 Në momentin e regjistrimit në programin e studimeve të doktoratës, kandidati pajiset me një numër unik matrikullimi, që e mban deri në marrjen e diplomës, i cili pasqyrohet në



regjistrin themeltar të njësisë kryesore. Formimi i numrit të matrikullimit (NIM) përcaktohet me Udhëzim të Ministrisë përgjegjëse për arsimin.

- 6.15 Në rastin kur studenti ç' regjistrohet nga programi i studimit, NIM-i i tij mbyllet dhe nuk përdoret për një student tjetër.
- 6.16 Në rastin kur studenti, transferohet në një program studimi të doktoratës, në një IAL tjetër, NIM-i i tij mbyllet dhe nuk përdoret për një student tjetër. Studenti pajiset me NIM tjetër në IAL-në ku transferohet.
- 6.17 Në rastin kur studenti shtyn/pezullon studimet, NIM-i nuk mbyllet dhe mbetet i njëjtë kur studenti i rifillon ato.

## **Neni 7**

### **Afatet në lidhje me pranimin në ciklin e tretë të studimeve**

- 7.1 Njësia/Njësitet bazë duhet të përcaktojë/përcaktojnë kapacitetet e pranimit dhe kriteret e përzgjedhjes së aplikantëve fitues për vitin akademik pasardhës deri në fund të muajit Maj të vitit akademik kur bëhet propozimi.
- 7.2 Njësia kyesore jo më vonë se java e parë e muajit Qershor të vitit kur bëhet propozimi, i përcjell Senatit Akademik të UT-së kapacitetet për secilën nga njësitet bazë të saj.
- 7.3 Njoftimi për pranimet e aplikimeve në programin e doktoraturës për vitin akademik pasardhës hapet 30 (tridhjetë) ditë përpara fillimit të tij. Afati i aplikimit është 15 ditë. Në momentin e hapjes së aplikimit çdo njësi kryesore ka detyrimin të bëjë publike në faqen zyrtare të saj si dhe në ambientet fizike kriteret dhe afatet e përcaktuara për të gjitha fushat e kërkimit shkencor që ajo ofron. Këto kritere nuk mund të ndryshohen deri në përfundim të procesit të pranimeve të reja
- 7.4 Kriteret e përgjithshme të pranimit të studentëve në programin e studimit të doktoratës përcaktohen nga njësitet bazë dhe miratohen në nivel njësie kryesore/dekanati.

## **Neni 8**

### **Kërkesat themelore të punës për realizimin e programit të studimit të doktoratës**

- 8.1 Gjatë periudhës së studimeve të doktoratës, para paraqitjes për mbrojtje, studenti duhet të ketë plotësuar kushtet e mëposhtme sipas VKM 112, datë 23.02.2018, ndryshuar me VKM Nr.808 datë 11.12.2019 dhe VKM 128 datë 06.03.2024.
  - a) Të ketë realizuar së paku, 3 (tre) referime ose paraqitje shkencore, si autor i parë ose i dytë, kur autori i parë është udhëheqësi shkencor, nga të cilët dy referime ose paraqitje të jenë mbajtur në një veprimtari shkencore/profesionale ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres) në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD, ose të G-20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në “proceedings”, të indeksuar me kod ISBN-je ose ISSN;
  - b) Të ketë botuar, së paku, 3 (tre) artikuj shkencorë në revista shkencore brenda vendit ose ndërkombëtare të indeksuara. Së paku, 1 (një) prej artikujve të jetë botuar në revista ndërkombëtare të indeksuara në Scopus, me indikatorë citimi, CiteScore ose



Scimago Journal Rank (SJR) dhe/ose Web of Science me indikatorë citimit të Journal Citation Report (JCR), faktor impakti IF ose Journal Citation Indicator (JCI), ku është së paku, autor i dytë

- c) Të ketë përfunduar disertacionin, sipas formatit të përcaktuar si më poshtë në këtë rregullore si dhe në rregulloret e lidhura me programin e tij të studimit. Disertacioni duhet të jetë në respektim të kuadrit ligjor dhe nënligjor, si edhe të akteve të miratuara nga UT, në lidhje me integritetin në kërkimin shkencor.

**8.2** Të paktën një herë në vit, njësia bazë duhet të shqyrtojë ecurinë e punës së doktorantit në programin e studimeve të doktoratës, bazuar në planin vjetor të punës, që doktoranti bën dhe vlerësimin me shkrim të udhëheqësit sipas një formati të paracaktuar. Në çdo raportim duhet të evidentohen arritjet e doktorantit për vitin përkatës dhe risitë që ai po sjell me kërkimin e tij.

**8.3** Të përfundojë punimin në përputhje me kriteret dhe brenda afateve të parashikuara në këtë rregullore. Punimi doctoral së bashku me dosjen, që përban dokumentacionin që tregon plotësimin e kriterëve si më sipër, i dorëzohet drejtuesit të njësisë kryesore, i cili ia përcjell për vlerësim njësisë bazë, për të vijuar më tej me procedurat për mbrojtje, sipas përcaktimeve në vijim në këtë rregullore.

## **Neni 9**

### **Të drejtat dhe detyrat e studentit të doktoratës**

**9.1** Studenti ka të drejtë:

- a. të njihet me paketën e akteve ligjore dhe nënligjore, që janë në funksion të procesit të studimeve të doktoratës dhe mbrojtjes së disertacionit për fitimin e gradës shkencore “Doktor”;
- b. të kërkojë krijimin e kushteve për ndjekjen e veprimtarive akademike dhe shkencore të parashikuara në programin e tij të studimeve të doktoratës;
- c. të shfrytëzojë bibliotekën e njësisë kryesore apo të njësive të tjera të UT-së, në varësi të specifikave përkatëse të kërkimit;
- ç. të shfrytëzojë bibliotekat e njësive të institucioneve me të cilat Universiteti i Tiranës ose njësia kryesore ka marrëveshje bashkëpunimi në fushën akademike apo/dhe shkencore, duke paraqitur pranë këtyre institucioneve dokumentin e lëshuar nga njësia kryesore, mbi qëllimin e studimit të kërkimit dhe statusin e tij si student i ciklit të tretë;
- d. të shfrytëzojë ambientet studimore/kërkimore dhe bazën e të dhënave pranë institucioneve publike/private, që do të mund t’i nevojiten atij për kërkimin shkencor, mbi bazën e rekomandimeve që njësia kryesore do të lëshojë rast pas rasti;



- dh. të pajiset me adresën zyrtare elektronike që do e përdorë për komunikim gjatë periudhës që gëzon statusin e doktorantit;
- e. të marrë pjesë dhe përfitojë nga formimi i vazhduar që institucioni ofron në kuadër të zhvillimit profesional;
- ë. të kërkojë dhe mbështetet me asistencën e nevojshme teorike në nënfusha të formimit që kanë lidhje me kërkimin e tij;
- f. të aplikojë dhe përfitojë nga kuotat e mobilitetit që institucioni vendos në shërbim të studentëve të tij gjatë kohës që gëzon statusin e studentit të doktoraturës;
- g. të marrë pjesë në aktivitetet shkencore dhe sociale të organizuara nga institucioni dhe njësitë e tij;
- gj. të përfaqësohet në aktivitete të kërkimit shkencor në logon zyrtare të UT;
- h. të mbështetet në nevojat e tij për mbledhjen e të dhënave nga palë të treta mes marrëveshjeve institucionale që lehtësojnë këtë proces;
- i. të tërhiqet vullnetarisht nga studimet e doktoratës duke paraqitur një kërkesë me shkrim në protokollin e njësisë kryesore për tu përcjellë tek drejtuesi i njësisë bazë, pasi të ketë përmbushur të gjitha detyrimet financiare deri në momentin e tërheqjes.
- j. të kërkojë pezullimin e studimeve sipas kësaj rregulloreje.
- k. të kërkojë saktësimin, ose ndërrimin e temës së doktoratës.
- l. të kërkojë në dakordësi me udhëheqësin, bashkëudhëheqje sipas kësaj rregulloreje.

## 9.2 Studenti ka për detyrë:

- a. të njohë dhe të plotësojë të gjitha detyrimet ligjore që rrjedhin nga kuadri ligjor dhe nënligjor në fuqi, përfshirë edhe këtë rregullore;
- b. të respektojë programin e miratuar të kërkimit të doktoratës;
- c. të respektojë afatet e parashikuara për realizimin e studimeve të doktoratës;
- ç. të respektojë afatet e parashikuara për shlyerjen e detyrimeve financiare, kur nuk financohen nga Universiteti i Tiranës. Pagesa e tarifës së shkollimit bëhet për çdo vit që ndiqen studimet doktorale.
- d. të raportojë, të paktën një herë në vit, në njësinë bazë mbi ecurinë e punës për realizimin e programit të kërkimit dhe veprimtarinë e tij kërkimore-shkencore;
- dh. të zbatojë standardet shkencore dhe etike të parashikuara për doktoratën në këtë rregullore dhe në aktet e tjera ligjore dhe nënligjore;
- e. të respektojë etikën dhe integritetin në kërkimin shkencor gjatë hartimit të disertacionit.



- ë. të dorëzojë brenda afateve ligjore disertacionin dhe dosjen përkatëse, sipas përcaktimeve në këtë rregullore, akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
- f. në rastet e publikimit të punimit kërkimor që lidhen me programin e doktoratës, duhet përdorë afilacionin UT dhe adresën e e-mailit, unitir. edu.al.
- g. pas regjistrimit në programin e doktoratës, duhet të regjistrohet në Google Scholar, me adresën e unitir.

## **Neni 10**

### **Përgjegjësitë e udhëheqësit shkencor të studentit**

- 10.1** Të garantojë zbatimin e të gjitha rregullave shkencore dhe etike të kërkimit shkencor, gjatë periudhës së udhëheqjes së doktoratës.
- 10.2** Të udhëheqë studentin për realizimin e kërkimit shkencor dhe përfundimin e disertacionit brenda kohës së parashikuar në aktet ligjore dhe nënligjore.
- 10.3** Të japë mbështetjen e duhur akademike dhe konsulencën e nevojshme që t'i mundësojë doktorantit arritjen e standardeve të larta të kërkimit shkencor. Kjo përfshin, ndër të tjera, edhe orientim në lidhje me strukturën e punimit, metodologjinë, rekomandime mbi literaturën dhe burime të tjera të informacionit, si edhe konsulencë të vazhdueshme për përmbajtjen e punimit.
- 10.4** Të mbajë komunikime të rregullta me doktorantin për ecurinë e punimit shkencor.
- 10.5** Të vlerësojë progresin e doktorantit rregullisht dhe të monitorojë punën e tij në përputhje me standardin e kërkuar. Të ndërjegjësojë doktorantin, në rastet kur puna e tij është nën standardin e kërkuar dhe të ndërmarrë veprimet e duhura mbështetëse.
- 10.6** Të mbështesë doktorantin për përgatitjen e materialeve kërkimore, përfshirë artikuj dhe prezantime për konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe në botime të tjera shkencore, kur tematika e tyre është në përputhje dhe funksion të kërkimit shkencor dhe punimit të doktoratës dhe në përmbushje të kriterëve të përcaktuara.
- 10.7** Të kontrollojë se kandidati i ka plotësuar të gjitha vërejtjet dhe rekomandimet, në rastet kur njësia bazë e ka kthyer punimin për riparaqitje dhe/ose plotësimin e dosjes.
- 10.8** Të garantojë përmbushjen e detyrimeve lidhur me individualitetin e punimit dhe eliminimit të plagjiaturës në përputhje me kriteret e përcaktuara në aktet rregullatore të detyrueshme për zbatim.
- 10.9** Në rastet e bashkëudhëqjes, me personel akademik vendas apo të huaj, që plotësojnë kriteret e përcaktuara në pikën 6.4, të kësaj rregulloreje, duhet që bashkëudhëheqësit të përcaktojnë qartë përgjegjësitë e tyre. Bashkëudhëheqësit duhet të mbajnë kontakte të rregullta mes tyre dhe me doktorantin.

Në këtë rast, udhëheqësit duhet, të nënshkruajnë një marrëveshje paraprake dhe individuale mes tyre për doktorantin që bashkëudhëheqin, në të cilën të jenë përcaktuar qartë të drejtat dhe detyrimet e palëve.



## **Neni 11**

### **Përgjegjësitë e Njesisë**

- 11.1** Njësia bazë është struktura përgjegjëse për zhvillimin e studimeve/punës për kërkimin shkencor, për hapjen dhe riorganizimin e programit të doktoratës dhe ndjekjen e të gjitha fazave të procesit të doktoratës.
- 11.2** Njësia bazë përcakton dhe miraton fushat/nënfushat e kërkimit shkencor, ku do të zhvillohen projektet e doktoratës.
- 11.3** Njësia bazë përcakton kapacitetet për pranimin e studentëve doktorantë.
- 11.4** Drejtuesi i njësisë bazë, miraton udhëheqësit shkencorë të studimeve të doktoratës në përputhje me fushat e kërkimit dhe/apo projektet kërkimore që njësia zhvillon në programin e doktoratës.
- 11.5** Njësia bazë ka përgjegjësi t’ju sigurojë studentëve doktorantë lehtësitë e nevojshme administrative për marrjen e informacionit dhe të literaturës së nevojshme kërkimore-shkencore pranë institucioneve publike dhe private.
- 11.6** Njësia bazë ka përgjegjësi të kontrollojë përmbushjen e kriterëve formale nga kandidatët, përpara përcjelljes për shqyrtim të dosjes së tyre nga Komisioni për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor”.
- 11.7** Njësia bazë ka përgjegjësi të shqyrtojë raportet e ecurisë së kërkimit shkencor, të paraqitura nga studentët dhe udhëheqësit dhe të garantojë se udhëheqësit kanë kontakt të rregullt me studentët. Në rastet kur konstaton probleme, njësia bazë propozon ndryshimet e nevojshme që ndjekin rregullimet sipas akteve ligjore e nënligjore dhe kësaj rregulloreje.
- 11.8** Drejtuesi i njësisë bazë dhe koordinatori i programit të doktoratës përkatëse kanë përgjegjësi të informojë studentët e pranuar në programin përkatës të doktoratës për aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse, përfshirë edhe këtë rregullore, që lidhen me procesin e fitimit të gradës shkencore.
- 11.9** Njësia bazë, bazuar në kërkesën për saktësime në temën e doktoraturës, paraqitur nga doktoranti dhe të nënshkruar prej tij dhe udhëheqësit, të bashkëshoqëruar me arsyet e kërkesës, vendos për miratimin ose jo të të këtij ndryshimi, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga dorëzimi i kërkesës. Saktësimet në përcaktimin e temës së doktoraturës mund të bëhen deri para fillimit të procedurave për mbrojtjen finale. Vendimi i njësisë bazë i përcillet drejtuesit të njësisë kryesore për evidentim në regjistrin përkatës.
- 11.10** Njësia bazë, bazuar në kërkesën për ndryshimin në temën e doktoraturës, paraqitur nga doktoranti dhe të nënshkruar prej tij dhe udhëheqësit, të bashkëshoqëruar me arsyet e kërkesës, vendos për miratimin ose jo të të këtij ndryshimi, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga dorëzimi i kërkesës. Ndryshimi i temës së doktoraturës mund të bëhen brenda fushës së kërkimit dhe brenda fushës së projektit kërkimor. Në rast se tema shtrihet në



një nënfushë të re si rezultat i nevojës për zgjerim të studimit, ndryshimi i temës në rast se vlerësohet i nevojshëm nga njësia bazë, bashkëshoqërohet edhe me aprovimin e bashkudhëheqësit të doktoraturës në respekt të pikës 6.3 të kësaj rregulloreje. Ndryshimi i temës bëhet vetëm brenda vitit të parë të studimeve të doktoraturës. Vendimi i njësisë bazë i përcillet drejtuesit të njësisë kryesore për evidentim në regjistrin përkatës.

- 11.11** Njësia bazë, shqyrton kërkesën për pezullim të studimeve të paraqitur nga doktoranti, në përputhje me pikën 15 të kësaj rregullore.
- 11.12** Njësia bazë raporton ecurinë vjetore të kërkimit shkencor të doktorantit dhe pas çdo raportimi i depoziton ato në dosjen e doktorantit pranë Degës së Kualifikimit Shkencor dhe Botimeve jo më vonë se 30 ditë nga dita e raportimit të doktorantit.
- 11.13** Njësia bazë harton në mënyrë periodike raporte mbi ecurinë e programit të doktoraturës, për të cilat informon edhe Komisionin për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor”.

## **Neni 12**

### **Detyrat e Përgjegjës të Programeve të Studimeve të Doktoratës**

Programet e doktoratës në nivel të njësisë kryesore ndiqen/drejtohen nga përgjegjësi i programeve të studimit të doktoratës, që është zëvendësdekani përgjegjës për programin e doktoratës, i cili ka përgjegjësi:

1. Të mbikëqyrë dhe të sigurojë që njësitet bazë respektojnë, në ushtrimin e përgjegjësive të tyre në lidhje me programet e studimit të doktoratës, kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi, këtë rregullore, në drejtim të:
  - respektimit të afateve dhe të kritereve për shpalljen e hapjes së programit të doktoratës;
  - respektimit të rregullave në lidhje me përzgjedhjen e kandidatëve fitues;
  - respektimit të kritereve në lidhje me udhëheqësit shkencorë, përfshirë, por jo vetëm, kriteret në lidhje me titullin akademik, që duhet të ketë udhëheqësi (“Profesor” ose “Profesor i asociuar”), numrin maksimal të doktorantëve që mund të udhëheqë, ekspertizën në fushën specifike të kërkimit.
  - respektimit të procedurave të udhëheqjes dhe shqyrtimit të ecurisë së kërkimit shkencor nga ana e njësive bazë.
2. Të mbikëqyrë dhe të sigurojë që studentët e doktoratës të informohen për të gjitha aktet ligjore, nënligjore, udhëzime dhe rregullore, që kanë të bëjnë me procesin e fitimit të gradës shkencore “Doktor”.
3. Të organizojë, në bashkëpunim me koordinatoret e programeve të doktoratës, raportimin vjetor në nivelin e njësisë kryesore, të ecurisë së punës së doktorantëve.



### **Neni 13**

#### **Detyrat e koordinatorit të programit të studimit të doktoratës**

- 13.1** Programi i studimit të doktoratës në nivel të njësisë bazë ndiqet/drejtohet nga koordinatori i programit të studimit të doktoratës të njësisë bazë, që caktohet nga drejtuesi i njësisë bazë ndërmjet anëtarëve të kategorisë “Profesor” dhe ka përgjegjësi:
- a. Të mbikqyrë mbarëvajtjen e programit të doktoratës;
  - b. Të garantojë që doktorantët të njihen me kuadrin ligjor përkatës, me detyrimet që duhet të përmbushin gjatë programit;
  - c. Të informojë doktorantët për thirrje të ndryshme për të cilat ata mund të kenë interes;
  - ç. Të interesohet për tu siguruar doktorantëve lehtësirat e nevojshme;
  - d. Të organizojë raportimet vjetore të doktorantëve;
  - dh. Të raportojë pranë njësisë bazë për konstatimet e tij/saj;
  - e. Të bashkëpunojë me zëvendësdekanin përkatës për raportimin vjetor në nivelin e njësisë kryesore, të ecurisë së punës së doktorantëve.

### **Neni 14**

#### **Përgjegjësitë e Komisionit për Dhënien e Gradës Shkencor “Doktor”**

- 14.1** Komisioni për Dhënien e Gradës Shkencore Doktor është Komisioni i përhershëm që ngrihet në nivel Njësie kryesore. Ai është përgjegjës për monitorimin e procesit të dhënies së gradës shkencore ‘Doktor’.
- 14.2** Komisioni përbëhet nga jo më pak se 5 (pesë) anëtarë dhe jo më shumë se 11 (njëmbëdhjetë) anëtarë, të cilët zgjidhen me vetëkandidim nga radhët e Asamblesë së personelit akademik. Anëtarët duhet të kenë titullin akademik “Profesor” ose “Profesor i Asociuar” dhe të kenë jo më pak se 5 (pesë) vite përvojë pune me kohë të plotë, si personel akademik.
- 14.3** Komisioni shqyrton projekt propozimet e njësisë bazë.
- 14.3** Komisioni është përgjegjës për shqyrtimin e dosjes së kandidatit dhe nëse vlerëson që dosja përmban të gjithë dokumentacionin e nevojshëm dhe përmbush kriteret e përcaktuara në këtë rregullore, ngre Jurinë brenda 30 ditëve nga marrja në shqyrtim e dosjes.
- 14.4** Komisionin administron disertacionin, përmbledhjen e miratuar nga udhëheqësi shkencor së bashku me raportimet, si dhe vlerësimet e njësisë përgjegjëse të programit të doktoratës.



**14.5** Komisioni është organi kompetent për vendimmarrjen në lidhje me dhënien e gradës shkencore “Doktor”, pas shqyrtimit të raportit të vlerësimit të Jurisë.

## **Neni 15**

### **Afati i studimeve të doktoratës**

**15.1** Studimet e doktoratës zgjasin normalisht 3 (tri) vite akademike dhe jo më shumë se 5 (pesë) vite akademike. Afati fillon të llogaritet nga dita kur përfundon afati i regjistrimit të fituesve.

Studimet e doktoratës zhvillohen:

- a. me kohë të plotë kur është personel akademik pranë njësisë bazë. Në këtë rast doktoranti, pajiset me një vërtetim të angazhimit akademik në njësinë ku ai është angazhuar;
- b. me kohë të zgjatur në ato raste kur doktoranti është i punësuar si personel akademik në një institucion tjetër të arsimit të lartë apo si personel kërkimor në një institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar.

**15.2** Gjatë studimeve të programit të doktoratës, studenti mund të kërkojë, pezullimin e studimeve të doktoratës.

**15.3** Pezullimi i studimeve

1. Gjatë studimeve të doktoratës, doktoranti mund të kërkojë pezullimin e studimeve për një nga shkaqet e mëposhtme:
  - a. kur sëmuret për periudha të gjata, të dokumentura me raport nga komisioni mjekoligjor,
  - b. në rast të fatkeqësive familjare të dokumentuara me dokumentacionin përkatës,
  - c. në rast të paaftësisë së përkohshme që ndikon në aftësinë për të përfunduar kërkimin të dokumentuar me dokumentacionin përkatës,
  - d. kur ka marrë lejen e shtatzanisë, lindjes apo lejen prindërore për kujdesin ndaj një fëmije të sapolindur apo të birësuar, të dokumentuar me raport nga institucioni përgjegjës,
  - e. në rast të situatave të emergjencave natyrore ose civile që ndikojnë drejtpërsëdrejti në aksesin në burime kërkimore ose në ndjekjen e studimeve të doktoratës.
2. Pezullimi i studimeve të doktoratës mund të kërkohet në çdo kohë nga doktoranti, përpara dorëzimit të kërkesës për fillimin e procedurave për mbrojtjen e doktoraturës.
3. Kërkesa për pezullim depozitohet me shkrim në protokollin e njësisë kryesore për tu përcjellë tek drejtuesi i njësisë bazë.



4. Njësia bazë shqyrton ekzistencën e plotësimin të kushteve për pezullim sipas paragrafit 1 të kësaj pike dhe brenda 10 (dhjetë) ditëve i paraqet vlerësimin e saj drejtuesit të njësisë kryesore.
5. Drejtuesi i njësisë kryesore brenda 5 (pesë) ditëve merr vendimin lidhur me kërkesën për pezullim, mbështetur në vlerësimin e komisionit *Ad hoc*. Nëse kërkesa miratohet, afati i pezullimit nuk mund të zgjasë më shumë se 1 (një) vit akademik.
6. Vendimi i drejtuesit të njësisë kryesore për pranimin/mospranimin e kërkesës për pezullim duhet të jepet i arsyetuar dhe t'i njoftohet njësisë bazë dhe kandidatit menjëherë pas marrjes së vendimit.
7. Kandidati ka të drejtë të bëjë ankimim pranë Rektorit lidhur me vendimin e drejtuesit të njësisë kryesore për refuzimin e kërkesës për pezullim ose për periudhën e aprovuar të pezullimit brenda 3 (tre) ditëve pune nga momenti i marrjes së njoftimit.
8. Rektori shqyrton ankesën dhe merr vendim përfundimtar për pranimin ose jo të ankesës brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pune nga dorëzimi i saj. Vendimi i Rektorit i përcillet Kandidatit dhe Njësisë ku është i regjistruar në programin e doktoraturës.
9. Gjatë periudhës së pezullimit afatet e përcaktuara për kohëzgjatjen e studimeve të doktoratës nuk ecin.
10. Doktoranti që nuk përfundon studimet brenda afatit (normal ose të zgjatur sipas këtij neni) humbet statusin e doktorantit dhe regjistrimi i tij në programin e doktoratës konsiderohet i përfunduar.

## **Neni 16**

### **Organizimi i procesit të miratimit të programeve ndërdisiplinare të doktoratës**

- 16.1** Njësitë bazë/kryesore mund të organizojnë programe të përbashkëta të studimeve të doktoratës me një ose më shumë njësi bazë të IAL-ve publike ose jopublike, brenda dhe jashtë vendit, bazuar në marrëveshje bashkëpunimi të lidhura përkatësisht, ku duhet të përcaktohet dhe njësia përgjegjëse për drejtimin e këtij bashkëpunimi.
- 16.2** Në programet e përbashkëta të doktoratës, njësitë bazë/kryesore duhet të kenë në konsideratë që:
  - a.** Fushat/nënfushat e kërkimit të jenë të ndërthurura dhe të përafërta;
  - b.** Në rastet se për realizimin e kërkimit të doktoratës në programe të përbashkëta nevojitet përdorimi i infrastrukturës së njësive në bashkëpunim, njësitë marrin përsipër rregullimin e kalendarit të kërkimit shkencor duke respektuar përcaktimet në marrëveshjen e bashkëpunimit;



- c. Në rastin programeve të përbashkëta caktohen dy udhëheqës, një për secilën njësi, të përfshirë në këtë program. Vlerësimi pozitiv i secilës njësi bazë, është kusht për të kaluar në mbrojtjen e tezës së doktoratës;
- ç. Procedura për mbrojtjen e gradës shkencore “Doktor” edhe në këtë rast realizohet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;
- d. Në përfundim të studimeve, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja dhe IAL-ja homologe lëshojnë diplomë të përbashkët apo të dyfishtë/shumëfishtë, sipas marrëveshjes së bashkëpunimit dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

## **Neni 17** **Bashkëudhëheqja**

- 17.1 Bashkëudhëheqje konsiderohet një formë bashkëpunimi akademik ku një doktorant udhëhiqet nga 2 anëtarë personel akademik i kategorisë “Profesor”.
- 17.2 Doktoranti dhe udhëheqësi mund t’i drejtojnë me shkrim njësisë bazë kërkesën për bashkëudhëheqje dhe pas regjistrimit në programin e doktoraturës, në rastet kur identifikohet nevoja për zgjerim të fushës së kërkimit, ose ekspertizë e specializuar në një aspekt të caktuar, që mbështet kërkimin e doktoratës.
- 17.3 Kur njësia bazë e konsideron të vlefshme kërkesën dhe në përputhje me qëllimet e kërkimit, ia përcjell kërkesën me arsyetimin dhe mbështetjen e saj, drejtuesit të njësisë kryesore, për ta përcjellë tek rektori. Pas shqyrtimit të kërkesës, ky i fundit merr vendimin lidhur me pranimin ose jo të kërkesës për bashkëudhëheqje brenda UT-së. Vendimi i njoftohet drejtuesit të njësisë kryesore, i cili ia përcjell njësisë bazë. Rektori vazhdon procedurat për miratimin në Ministrinë përgjegjëse dhe regjistrimit të bashkëudhëheqjes në QSHA. Pas miratimit nga Ministria përgjegjëse dhe regjistrimit në QSHA, bëhen shënimet përkatëse në regjistrin e njësisë kryesore për regjistrimin e bashkëudhëheqjes.
- 17.4 Kohëzgjatja e bashkëudhëheqjes është në varësi të nevojave akademike të doktorantit. Minimuni i kohës së bashkëudhëheqjes për efekt të promovimit akademik të bashkëudhëheqësit është 2 (dy) vjet. Bashkëudhëheqësit kanë detyrimin ta udhëheqin doktorantin deri në fitimin e gradës shkencore “Doktor”.
- 17.5 Në rastet kur personeli akademik i UT-së do të angazhohet në bashkëudhëheqje në institucione të tjera të arsimit të lartë, dokumentacioni që duhet të dorëzohet pranë njësisë bazë ku është i angazhuar, me qëllim fillimin e procedurave për marrjen e dakordësisë/miratimin nga institucioni, është si më poshtë:
  - 1. Staf i akademik i kategorisë “Profesor” dorëzon kërkesën për shqyrtim dhe lejim të angazhimit si udhëheqës shkencor në IAL tjetër, pranë njësisë së tij bazë.



Kërkesa duhet të përmbajë të dhëna mbi:

- a. Titullin e projektit kërkimor shkencor,
  - b. Fushën kërkimore në të cilën do të përfshihet si bashkëudhëheqës,
  - c. Emërtimin e njësisë bazë, njësisë kryesore dhe institucionit ku do të angazhohet personeli akademik në bashkëudhëheqje,
  - d. Vendimin e IAL-së ku do të kryhet bashkëudhëheqja, i cili e pranon si udhëheqës shkencor.
2. Drejtuesi i njësisë bazë pas shqyrtimit në njësinë e tij e përcjell kërkesën e udhëheqësit shkencor, drejtuesit të njësisë kryesore.
  3. Drejtuesi i njësisë kryesore, përcjell propozimin e Njësisë bazë për bashkëudhëheqjen e kërkuar, pranë Rektoratit të UT-së.
  4. Rektori i UT-së jep vendimin për angazhimin e personelit akademik në bashkëudhëheqje pranë IAL-së tjetër dhe e përcjell vendimin pranë njësisë kryesore.
  5. Për të gjitha rastet e kërkesës së angazhimit të personelit akademik në bashkëudhëheqje në institucione të tjera të arsimit të lartë, duhet të ketë një Marrëveshje paraprake bashkëpunimi midis UT-së dhe IAL-së përkatës.

**17.6** Në rastet kur njësia bazë/kryesore për nevoja të kërkimit shpreh interes për bashkëpunim me individë/njësi të IAL të tjera procedura e këtij bashkëpunimi është si më poshtë vijon:

1. Personeli akademik i UT i kategorisë “Profesor”, ose njësia bazë/kryesore që shpreh interes për të bashkëpunuar përmes bashkëudhëheqjes me njësi ose personel akademik i IAL të tjera përcjell kërkesën për bashkëpunim.
2. Kërkesa përcillet nga njësia bazë e interesuar për këtë bashkëpunim edhe në rastin kur kjo kërkesë inicohet nga personeli akademik i kësaj njësie të UT-së.
3. Së bashku me kërkesën drejtuesi i njësisë bazë i përcjell drejtuesit të njësisë kryesore dhe një qëndrim të njësisë bazë për këtë kërkesë.
4. Drejtuesi i njësisë kryesore, përcjell Rektorit të UT-së kërkesën shoqëruar me dokumentacionin si më poshtë vijon:
  - a. Titulli i projektit kërkimor shkencor ku kërkohet bashkëpunimi/bashkëudhëheqje.
  - b. Fusha kërkimore në të cilën kërkohet përfshirja e personelit akademik ose njësisë bazë nga IAL- të e tjera.
  - c. Emërtimi i njësisë bazë, njësisë kryesore dhe institucionit me të cilët do të bashkëpunohet në bashkëudhëheqje.
  - ç. Arsyetimi shkencor mbi nevojën e këtij bashkëpunimi/bashkëudhëheqje dhe përfitimet e UT-së në kuadër të tij.
  - d. Kapacitetin shkencor dhe infrastrukturor që njësia bazë/personeli akademik i IAL-së tjetër ofron në këtë bashkëpunim.
  - dh. Leja e drejtuesit të IAL-së me të cilën kërkohet bashkëpunimi.
5. Rektori i UT-së jep vendimin për angazhimin e personelit akademik të një IAL-je tjetër në bashkëudhëheqje pranë UT-së.



6. Për të gjitha rastet e kërkesës së angazhimit të personelit akademik ose njësisë të IAL-ve të tjera në bashkëudhëheqje me personel akademik të UT-së, duhet të ketë një Marrëveshje paraprake bashkëpunimi midis UT-së dhe IAL-së përkatës, si dhe një marrëveshje të posaçme të lidhur midis Rektorit të UT-së dhe personelit akademik të njësisë bazë të IAL-së me të cilën do të bashkëpunohet.
7. Në rast se bashkëpunimi realizohet mes dy njësisë bazë nga dy IAL të ndryshme, një nga UT dhe një nga një IAL tjetër, marrëveshja e posaçme nënshkruhet midis dy rektorëve përkatës.
8. Personeli akademik i IAL-së tjetër gjatë kohës së bashkëpunimit merr statusin e personelit akademik të jashtëm për kohën e bashkëpunimit të rregulluar sipas pikës 9 të këtij neni.
9. Kushtet, koha dhe pagesa mbi përqindjen e orëve të punës që bashkëudhëheqësit ndajnë mes tyre, të llogaritura këto mbi numrin maksimal të orëve që legjislacioni në fuqi parashikon për udhëheqjen e një doktoranti, specifikohen në marrëveshjen e posaçme.
10. Pronësia intelektuale mbi produktet shkencore të prodhuara nga ky bashkëpunim, i takon UT-së.
11. Për efekt të plotësimit të kriterëve, për marrjen e titullit “Profesor”, bashkëudhëheqësi, duhet të jetë angazhuar, të paktën dy vitet e fundit të punës së doktorantit, para dorëzimit të disertacionit, dhe për këtë periudhë, të jetë marrë miratimi si kapacitet akademik nga ministri përgjegjës për arsimin.

### **Neni 18 Ndërrimi i udhëheqësit**

- 18.1** Në rastet kur ka shkaqe objektive të dokumentuara, të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e studimeve doktorale, udhëheqësi ose doktoranti kanë të drejtë të kërkojnë ndërrimin e udhëheqësit. Kërkesa për ndërrimin e udhëheqësit shkencor dorëzohet me shkrim në protokollin e njësisë kryesore për tu përcjellë tek drejtuesi i njësisë bazë.
- 18.2** Njësia bazë shqyrton kërkesën dhe merr vendim jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune nga marrja e kërkesës. Vendimi i njoftohet drejtuesit të njësisë kryesore për të vazhduar procedurat për rregjistrimin e udhëheqësit ekzistues dhe rregjistrimin e udhëheqësit të ri në rregjistrin e njësisë kryesore dhe njoftimin e Ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor dhe QSHA-së nëpërmjet Rektorit.

### **Neni 19 Formimi dhe funksionimi i jurisë për mbrojtjen e doktoratës**

- 19.1** Mbrojtja e doktoratës bëhet përpara një jurie të përbërë nga 5 (pesë) anëtarë të kategorisë “Profesor”, mes së cilëve të paktën 3 (tre) mbajnë titullin “Profesor”, si dhe 2 (dy) anëtarë të kësaj jurie i përkasin personelit akademik të njësisë bazë nga IAL të



tjera vendase ose të huaja. Anëtarët e jurisë duhet të jenë të së njëjtës fushë të kërkimit shkencor me atë të programit të doktoratës ose të fushave të ngjashme.

**19.2** Ngritja e jurisë bëhet pasi kandidati i ka plotësuar të gjitha kërkesat e parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe në këtë Rregullore, si dhe ka përfunduar punimin e tij doktoral, duke u ndjekur kjo procedurë:

**a.** Kandidati dorëzon draft punimin në 2 (dy) kopje së bashku me miratimin e udhëheqësit për fillimin e procedurave të mbrojtjes së doktoratës, tek drejtuesi i njësisë kryesore. Drejtuesi i njësisë kryesore, draft punimin së bashku me dosjen e kandidatit të plotësuar në kohë, që administrohet nga personeli ndihmësakademik, e përcjell për verifikim të plotësimit të kriterëve bazë, tek përgjegjësi i programit të studimit. Pas verifikimit të përmbushjes së detyrimeve të doktorantit, drejtuesi i njësisë kryesore përcjell në njësinë bazë draft punimin dhe dosjen personale, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike, nga data e marrjes.

**b.** Njësia bazë vlerëson kriteret formale dhe kontrollin antiplagjiaturë brenda 30 (tridhjetë) ditëve. Në rast vlerësimi pozitiv disertacioni dhe dosja e kandidatit dhe propozimi i Jurisë i miratuar nga drejtuesi i njësisë kryesore, i përcillen Komisionit për dhënien e gradës shkencore “Doktor”. Njësia bazë ndjek procedurën e vlerësimit si më poshtë vijon:

1. Drejtuesi i njësisë bazë në bashkëpunim me udhëheqësin e doktoratës, cakton dy recenzentë të kategorisë “Profesor”, një nga të cilët është personel akademik i njësisë bazë dhe një tjetër, personel akademik i jashtëm në të njëjtën fushë kërkimi. Recenzentët përgatisin recensën dhe i’a dorëzojnë drejtuesit të njësisë bazë;

2. Drejtuesi i njësisë bazë organizon mbledhjen e njësisë bazë, në prani të kandidatit, i cili prezanton punimin e tij. Në mbledhje, recenzentët prezantojnë recensat e tyre dhe personeli akademik i njësisë bazë mund t’i drejtojë kandidatit pyetje dhe të japë sugjerime. Në varësi të komenteve dhe sugjerimeve të dhëna, kandidatit i jepet jo më shumë se,7 (shtatë) ditë kohë, për pasqyrimin e tyre në draft punimin;

3. Nëse njësia bazë jep vlerësim negativ për draft punimin doktoral dhe/ose dosjen, kandidati ka të drejtë të riparaqesë draft punimin dhe/ose dosjen e plotësuar, jo më parë se 3 (tre) muaj.

4. Pas vlerësimit nga udhëheqësi i doktoratës të punimit të rishikuar nga kandidati, si dhe pas kontrollit antiplagjiaturë, drejtuesi i njësisë bazë i përcjell Komisionit për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor”, punimin doktoral dhe dosjen e kandidatit;

5. Nëse Komisioni e vlerëson pozitivisht dosjen, brenda 30 (tridhjetë) ditëve ngre jurinë për vlerësimin e punimit doktoral. Si rregull, recenzentët përzgjidhen në juri si oponentë.

**19.3** Komisioni për Dhënien e Gradave merr vendim për ngritjen e Jurisë, të cilën e përzgjedh nga një listë me jo më pak se 8 (tetë) anëtarë, e propozuar nga njësia bazë dhe e miratuar nga Drejtuesi i njësisë kryesore. Anëtarët e jurisë duhet t’i përkasin kategorisë “Profesor”. Dy anëtarë të jurisë caktohen oponentë për vlerësimin e disertacionit, ku



njëri është anëtar i jashtëm. Njëri prej anëtarëve të jurisë, personel akademik i brendshëm, caktohet kryetar i saj.

**19.4** Vendimi për ngritjen e Jurisë, nëpërmjet drejtuesit të njësisë kryesore, i përcillet për dijeni njësisë bazë përkatëse. Dega e Kualifikimit shkencor dhe Botimeve ndjek procedurat e mbrojtjes.

**19.5** Brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga formimi i saj, Juria cakton datën e mbrojtjes së disertacionit. Data duhet të jetë jo më herët se 15 ditë dhe jo më vonë se 45 ditë nga data e vendimit për ngritjen e jurisë. Kryetari i jurisë bën publike datën e mbrojtjes.

**19.6** Kur, për arsye të përligjura, njëri nga anëtarët e Jurisë nuk mund të jetë pjesë e jurisë së caktuar për mbrojtjen e doktoratës, kryetari i jurisë i kërkon Komisionit zëvendësimin e anëtarit të jurisë. Komisioni duhet të bëjë zëvendësimin jo më vonë se 10 ditë (pune) nga marrja e kërkesës, nga lista e propozuar më parë nga njësia bazë dhe e miratuar nga Drejtuesi i njësisë kryesore.

Në rastin kur doktoranti, për arsye të përligjura, nuk mund të jetë i pranishëm në datën e caktuar për mbrojtjen e doktoratës, Juria cakton një datë tjetër për mbrojtjen, por jo më vonë se 30 ditë nga data e vendosur më parë.

**19.7** Pas prezantimit të disertacionit nga doktoranti, Juria harton raportin e vlerësimit dhe ia dërgon atë Komisionit jo më vonë se 30 ditë nga dita e mbrojtjes së disertacionit.

**19.8** Nëse njësia bazë ose Komisioni jep vlerësim negativ për disertacionin ose dosjen për plotësimin e kriterëve formale, kandidati ka të drejtë të riparqesë dizertacionin dhe/ose dosjen e plotësuar pas një periudhe jo më të shkurtër se 3 (tre) muaj nga dita e marrjes së njoftimit përcjellë doktorantit nga drejtuesi i njësisë kryesore.

**19.9** Në rastet e indentifikimit të plagjaturës rregullimi bëhet bazuar në rregulloren e antiplagjaturës së UT-së.

## **Neni 20**

### **Mbrojtja e disertacionit dhe fitimi i gradës shkencore “Doktor”**

**20.1** Mbrojtja e disertacionit bëhet si rregull e hapur, me përjashtim të rasteve kur, për natyrën e veçantë të çështjeve të trajtuara (sekrete, të dhëna konfidenciale etj.) duhet të bëhet e mbyllur. Drejtuesi i njësisë kryesore, me kërkesë të njësisë bazë, autorizon mbrojtjen me publik të kufizuar, sipas propozimit të Komisionit për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor”.

**20.2** Disertacioni prezantohet para Jurisë, e cila e vlerëson atë.

**20.3** Procedura e mbrojtjes së punimit daktoral përfshin:



- paraqitjen nga kryetari i jurisë të dokumentacionit të dosjes, përbërjes së jurisë dhe deklarimit nga ana e tij për hapjen e procedurës së mbrojtjes;
- paraqitjen e disertacionit nga studenti për një kohë prej 20-30 minuta;
- paraqitjen e oponencave. Oponentët japin vlerësimin me shkrim të punimit doktoral, ku saktësohet nëse punimi në tërësi i përmbush kërkesat e paraqitura në programin e doktoratës, duke iu kushtuar vëmendje vlerave origjinale, që paraqet punimi, si dhe duke vënë në dukje anët pozitive e negative të tij (nëse ka të tilla);
- pyetje nga të pranishmit rreth punimit dhe oponencave, drejtuar studentit doktorant;
- diskutime;
- sqarime eventuale nga studenti doktorant dhe udhëheqësi shkencor;
- shpërndarjen e fletëvotimeve të hapura e të paplotësuara dhe votim i fshehtë për vlerësimin e doktoratës;
- pasqyrimin në procesverbal të rezultatit të votimit dhe shpalljen e vendimit me shkrim.

**20.4** Punimi vlerësohet me pikë, nga 0 – 100 pikë. 100-80% e pikëve të mundshme = “shumë mirë”, 79-65% e pikëve të mundshme = “mirë”, 64-50% e pikëve të mundshme = “mjaftueshëm”, 49% e më pak e pikëve të mundshme = “pakalueshëm”.

**20.5** Pas mbrojtjes së disertacionit me vlerësim pozitiv nga Juria, njësia kryesore përcjell një kopje të disertacionit në Bibliotekën Kombëtare, një kopje në Bibliotekën Shkencore të njësisë kryesore. Dëshmitë e këtyre depozitimeve i përcillen Komisionit për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor”, para përmbjlljes së procedurave për dhënien e gradës shkencore “Doktor”.

**20.6** Komisioni, pasi merr Raportin e Vlerësimit nga juria, në mbledhjen e rradhës, si dhe dëshmitë e depozitimeve në biblioteka, merr vendimin mbi dhënien e gradës shkencore “Doktor” dhe ia përcjell atë për procedura të mëtejshme drejtuesit të njësisë kryesore.

**20.7** Vendimin e Komisionit, 3 (tre) kopje të disertacionit në format elektronik, si dhe të dhënat e nevojshme për gjenerimin e diplomës, drejtuesi i njësisë kryesore i përcjell në rektoratin e UT-së.

**20.8** Lista e të diplomuarve në programet e ciklit të tretë i përcillet Universitetit të Tiranës dhe prej andej Ministrisë përgjegjëse për arsimin, për t’u pasqyruar në regjistrin shtetëror të gradave shkencore e titujve akademikë dhe në regjistrat përkatës të IAL-së, si dhe në QSHA.

**20.9** Në përfundim të studimeve lëshohet diploma e gradës shkencore “Doktor”, e cila nënshkruhet nga drejtuesi i njësisë kryesore dhe Rektori.



## **Mospërfundimi ose ndërprerja e studimeve të doktoratës**

- 21.1** Mospërfundim i studimeve të doktoratës konsiderohet rasti kur doktoranti nuk arrin të përfundojë brenda afateve ligjore mbrojtjen e gradës shkencore “Doktor”.
- 21.2** Ndërprerja konsiderohet ndërprerja e programit të studimit me kërkesë me shkrim të kandidatit, paraqitur drejtuesit të Njesisë Kryesore.
- 21.3** Në rast të mospërfundimit ose ndërprerjes të studimeve me kërkesë të tij, mund të pajiset me një vërtetim që pasqyron rastin konkret. Vërtetimi lëshohet nga drejtuesi i njesisë kryesore.
- 21.4** Njësia kryesore njofton QSHA përmes Rektorit të UT-së për ndërprerjen e marrëdhënieve të doktorantit dhe çregjistrimin e tij nga lista e doktorantëve të UT-së.

## **Neni 22**

### **Transferimi i studimeve në programin e doktoratës**

- 22.1.** Kandidatët që ndjekin një program studimi të doktoratës në institucione të arsimit të lartë, vendas ose të huaj, lejohet të transferojnë këto studime, kur fushat e studimit janë të njëjta ose të përafërta me programin e “Doktoratës”, të njesisë kryesore.
- 22.2** Me qëllim lejimin e transferimit të doktoratës, nga një IAL tjetër vendase ose të huaj, në Universitetin e Tiranës, njësia bazë ngre një Komision *Ad hoc*, me tre anëtarë, për të verifikuar nivelin e ngjashmërisë së programeve të doktoratave, fazën dhe nivelin e punimit të doktorantit. Drejtuesi i njesisë bazë i dërgon propozimin e Komisionit *Ad hoc* drejtuesit të njesisë kryesore, i cili ia përcjell për vendim Rektorit.
- 22.3** Kur transferimi kërkohet nga një kandidat i një institucioni tjetër të arsimit të lartë, për në Universitetin e Tiranës dhe programi i doktoratës kryhet me vetëfinancim, transferimi kryhet duke mbajtur parasysh kriteret e parashikuara nga kjo Rregullore, për pranimin në një program studimi të doktoratës.
- 22.4** Kur transferimi kërkohet nga një kandidat në program studimi të doktoratës nga Universiteti i Tiranës në një institucion tjetër të arsimit të lartë dhe programi i doktoratës kryhet me vetëfinancim, transferimi kryhet duke mbajtur parasysh kriteret e parashikuara nga kjo Rregullore.
- 22.5** Kur burimi i financimit nuk është vetëfinancim, transferimi mund të kryhet në varësi të burimit të financimit.
- 22.6** Verifikimi i mundësisë së transferimit të programit të studimeve të doktoratës, sipas pikave 22.3 dhe 22.4 të këtij neni, bëhet nga një komision *Ad hoc* i ngritur pranë njesisë



bazë, që ka organizuar këtë program studimi. Vendimi përfundimtar merret nga Rektori, pas propozimit të drejtuesit të njësisë kryesore.

**22.7** Në rast financimi nga UT, për kërkimin shkencor mbi projektin e doktoratës përkatëse, kandidati që kërkon transferimin në një tjetër IAL, vendase ose të huaj, së bashku me kërkesën e tij për transferim, humbet financimin nga UT-ja, si dhe do të kompensojë UT-në për financimin e bërë.

**22.8** Në çdo rast transferimi, doktoranti duhet të ketë konfirmim zyrtar nga institucioni ku do të transferohet se, ky i fundit ka kapacitete të lira për udhëheqjen e kandidatit që kërkon të transferojë studimet dhe e pranon kandidatin.

### **Neni 23**

#### **Rregullat për paraqitjen e punimit doktoral**

**23.1** Punimi duhet të reflektojë fushat / nënfushat e programeve të studimit të doktoratës si dhe aftësinë profesionale të studentit për kërkim shkencor.

**23.2** Punimi duhet të sjellë risi teorike dhe/ose empirike në fushën përkatëse të kërkimit si dhe të jetë një kontribut në pasurimin e njohurive shkencore si dhe me një impakt shoqëror.

**23.3** Punimi doktoral hartohet në gjuhën shqipe dhe një përmbledhje e tij (2000-4000 fjalë) në një nga pesë gjuhët e Bashkimit Europian: (*anglisht, frengjisht, gjermanisht, spanjisht, italisht*) në format të shtypur dhe elektronik. Përpara dorëzimit punimi miratohet nga udhëheqësi shkencor.

**23.4** Përcaktimi i gjatësisë së punimit është jo më pak se, 180 (njëqind e tetëdhjetë) fletë.

**23.5** Disertacioni paraqitet në 3 (tre) kopje origjinale. Punimi duhet të respektojë kërkesat e formatit. Nëse punimi nuk prezantohet sipas formatit të kërkuar, ai nuk pranohet deri sa të plotësohen të gjitha kërkesat për paraqitjen e punimit dhe formatin. Punimi që duhet të plotësojë kriteret, si vijon:

**a.** Lloji i shkrimit që duhet të përdoret në punimin doktoral, është Times New Roman, masa e shkronjës duhet të jetë 12-she, *justify*, hapësirë ndërmjet rreshtave 1.15 (një pikë pesëmbëdhjetë), përveç rasteve kur në këtë Rregullore kërkohet ndryshe.

**b.** Margjinat për të gjithë tekstin do të jenë:

- Margjina e sipërme 1”
- Margjina e poshtme 1”
- Margjina e majtë 1.25”
- Margjina e djathtë 1.25”

**c.** Të gjitha numrat e faqeve duhet të vendosen poshtë dhe në mes të faqes.



- ç. Parathënia duhet të shtypet me shkronja korsive.
- d. Hyrja duhet të ketë numra romakë.
- dh. Pjesa e studimit duhet të ketë numra arabë.
- e. Faqet e bibliografisë, shtojcave duhet të numërohen me numra arabë në vijim të numrit të faqeve të studimit. Referencat duhet të formatohen sipas njërit prej standardeve ndërkombëtare të pranueshme: Chicago Style ose APA Style.
- ë. Shënimet në tekstin e punimit, bëhen në fund të faqes (foot note), me program kompjuterik, në Times New Roman, masa e shkronjës duhet të jetë 10-she, *justify*, hapësirë ndërmjet rreshtave 1 (një).
- f. Tabelat e përfshira në tekst, duhet të vendosen në qendër të faqes, brenda margjinave të caktuara. Çdo tabelë i duhet vendosur një numër referimi me numër arab. Numërimi i tabelave në punim bëhet me numra të njëpasnjëshëm. Fjala “Tabelë”, numri i tabelës dhe legjenda, duhet të vendosen në krye të tabelës. Nëse tabela vazhdon në faqen tjetër legjenda nuk përsëritet. Nëse një tabelë përmban citate ose referime, ato duhet të vendosen në *foot note*. Si rregull, në shkrimin brenda tabelës, masa e shkronjës duhet të jetë 10-she dhe hapësirë ndërmjet rreshtave 1 (një), *justify*, përveç rasteve kur zbatimi i këtyre elementëve teknikë, ndikon në paraqitjen vizuale të tabelës.
- g. Diagramat, fotografitë, ilustrimet dhe grafikët, pasqyrohen në tekst me emërtimin “Figurë”. Çdo figure, i duhet vendosur një numër referimi me numër arab. Numërimi i figurave bëhet me numra të njëpasnjëshëm. Fjala “Figurë”, numri i saj dhe legjenda, vendosen poshtë. Nëse një figurë përmban citate ose referime, ato duhet të vendosen në *foot note*. Si rregull, në emërtimin e figurave, masa e shkronjës duhet të jetë 12-she dhe hapësira ndërmjet rreshtave 1.15 (një pikë pesëmbëdhjetë), *justify*, përveç rasteve kur zbatimi i këtyre elementëve teknikë, ndikon në paraqitjen vizuale të tyre. Përgjithësisht figurat, nuk duhet të kalojnë një faqe. Nëse ato vazhdojnë në faqen tjetër, duhet të ndiqet rregulli si për tabelat.
- gj. Materialet shoqëruese - Nëse një punim përmban materiale shoqëruese të tilla, si : CD, video ose kasetat etj. që janë një pjesë e rëndësishme e punimit, ato duhet t’i bashkëngjiten punimit.
- h. Shtypja - Materiali duhet të shtypet vetëm nga njëra anë e fletës. Të gjitha kopjet e punimit duhet të jenë të shtypura me kompjuter, të printuara qartë dhe të jenë të lexueshme lehtësisht. Nuk pranohen dorëshkrimet.
- i. Cilësia e shtypjes – Teksti duhet të shtypet me hapësirë një ndërmjet radhëve. Hapësira njëshe do të përdoret edhe për përgatitjen e tabelave të gjata, të ekstrakteve, të shënimeve, të shpjegimeve të gjata dhe të listës së bibliografisë.
- j. Lloji i letrës - Duhet përdorur letër e cilësisë së lartë, e bardhë, format A4.
- k. Punimi në variantin e tij final, dorëzohet të paktën në 3 (tre) kopje origjinale 1 (një) ndër të cilat ruhet në dosjen e kandidatit, si dhe në formë elektronike në pdf.



- I. Në kapakun e përparmë të kopertinës të punimit, duhet të vendoset:
- Emri i Universitetit/Universiteteve në rast diplome të përbashët ose dyfishe (në krye, në mes të kopertinës);
  - Emri i Fakultetit/Institutit (në krye, mes të kopertinës);
  - Emri i Departamentit, ku është zhvilluar programi i doktoratës (në krye, në mes të kopertinës);
  - Stema e Universitetit/Universiteteve në rast diplome të përbashët ose dyfishe (në krye, në anën e majtë të kopertinës);
  - Stema e Fakultetit/Institutit (në krye, në anën e djathtë të kopertinës);
  - Fjala DISERTACION (në mes të kopertinës);
  - Emri i programit të doktoratës (në mes të kopertinës);
  - Emri i kandidatit (në fund, në anën e majtë të kopertinës);
  - Emri dhe titulli i udhëheqësit (në fund, në anën e djathtë të kopertinës);
  - Qyteti dhe viti i mbrojtjes (në fund, në mes të kopertinës).

Pjesa e pasme e kopertinës duhet të përmbajë:

- **Abstraktin në shqip dhe në anglisht.** Secili variant duhet të përmbajë 200 fjalë duke u përdorur masa 10–she e shkronjës. Ky element duhet t’u mundësojë lexuesve vendas dhe të huaj të kuptojnë sesi është trajtuar çështja e marrë në studim. Abstrakti në anglisht është një kërkesë e standardeve ndërkombëtare.

**Fushën dhe fjalët kyçe.** Studenti në bashkëpunim me udhëheqësin shkencor përcakton fushën dhe zgjedh fjalët kyçe në funksion të përshtatshmërisë së tyre me terminologjinë e përdorur në disipinën përkatëse. Ato ndihmojnë identifikimin e tezës midis katalogëve kolektive në biblioteka.

## Neni 24 Etika e punës kërkimore

- 24.1** Çdo disertacion duhet të reflektojë rregullat që lidhen me etikën e punës kërkimore dhe integritetin akademik, në respektim të etikës dhe integritetit në kërkimin shkencor.
- 24.2** Kur dorëzon disertacionin, kandidati duhet të deklarojë me shkrim se studimi është punë origjinale e tij.
- 24.3** Kandidati nuk lejohet të paraqesë një punim që e ka paraqitur më parë në të njëjtën njësi ose në një njësi tjetër për marrjen e një grade tjetër. Ai mund të paraqesë një pjesë të punës, nëse e tregon qartë cila pjesë është përdorur më parë, e cila nuk mund të jetë më



shumë se 20% e punimit. Kandidati mund të përfshijë në punim edhe pjesë nga studime individuale apo të realizuara me bashkautorë, ose të dhëna të përfituara nga kërkime në kuadër të projekteve kërkimore të tjera. Nëse kërkimi është realizuar në ekip, kandidati e evidenton këtë fakt dhe njeh kontributin e bashkëpunëtorëve.

**24.4** Gjatë periudhës së përgatitjes së punimit, kandidati mund të botojë pjesë të studimit shkencor në formën e artikujve apo referimeve shkencore (me lejen me shkrim të udhëheqësit).

**24.5** Punimi nuk duhet të përmbajë elementë që përbëjnë plagjiaturë. Në çdo rast që përdoren ide, fjalë apo koncepte nga burime të tjera duhet të shënohet referenca përkatëse.

**24.6** Nëse burimi origjinal nuk gjendet, por është përmendur në një dokument tjetër, atëherë duhet të përmenden të dyja dokumentet, burimi origjinal dhe ai dytësor.

**24.7** Udhëheqësi duhet të sqarojë kandidatin që në fillim të punës për rrezikun dhe pasojat në rastet e konstatimit të mashtrimit, falsifikimi dhe plagjiaturës.

**24.8** Pronësia intelektuale, e drejta e autorit për punimin (si edhe për çdo material të botuar), mbrohet nga ligji i së drejtës të autorit dhe akte të tjera të zbatueshme në këtë drejtim. Shënimi për rezervimin e së drejtës së autorit, simboli përkatës ©, emri i zotëruesit të autorësisë, viti i punimit duhet të vendosen në faqen që vjen pas titullit të punimit.

## **Neni 25** **Financimi**

Vlera e doktoratës planifikohet dhe mbulohet nga fondet për kërkim shkencor të njësisë bazë organizuese ose të njësisë kryesore dhe/ose nga grantet e punës kërkimore-shkencore, që financohen nga buxheti i shtetit në përputhje me rregullimet ligjore në fuqi dhe/ose nga institucione të tjera financuese dhe/ose nga burime të tjera publike dhe jopublike. Ajo mund edhe të vetëfinancohet nga studenti doktorant.

## **Neni 26** **Dispozita kalimtare**

Kjo rregullore zbatohet për studentët që do të regjistrohen në programet e studimit të doktoratës pas hyrjes në fuqi të saj. Për studentët që kanë filluar programin para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje,

**a.** kjo rregullore do të zbatohet vetëm për procedurat e mbrojtjes për doktorantët që nuk i kanë filluar akoma këto procedura.

**b.** do të zbatohen dispozitat përkatëse të Ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë” dhe të akteve nënligjore në bazë dhe për zbatim të tij që kanë qenë në fuqi në kohën e fillimit të programit të studimit.



**Neni 27**

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Dekanati i Fakultetit të Gjuhëve të Huaja.

**DEKAN**

**Prof. Dr. Esmeralda KROMIDHA**

